



Riskedulim i afatit për dorëzimin e pasqyrave financiare dhe pagesës së tatimit mbi fitimin

Me qëllim përballimin e pasojave financiare të shkaktuara nga COVID-19, Këshilli i Ministrave ka miratuar Aktin Normativ nr. 10, datë 26.03.2020 botuar në Fletoren Zyrtare nr. 52, datë 26.03.2020 i cili parashikon zgjatje të afatit për dorëzimin e pasqyrave financiare, si dhe deklarin dhe pagesën e tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019, për kategori të caktuara tatimpaguesish.

Është e rëndësishme të theksohet se **këto afate janë të zbatueshme vetëm për ata tatimpagues të cilët janë subjekt i Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" dhe jo për tatimpaguesit subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, i cili rregullohet nga Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore"**. Më poshtë paraqiten në mënyrë skematike, afatet e reja të dorëzimit dhe pagesës, si dhe kategoritë e tatimpaguesve të cilëve iu zbatohen:

Detyrimi ligjor	Kategoria e tatimpaguesve	Afati ligjor i zakonshëm	Afati ligjor përjashtimor për vitin 2020
Dorëzimi në e-tax i pasqyrave financiare vjetore dhe raportit të auditimit ligjor mbi to (kur ky është i detyrueshëm)	Të gjithë tatimpaguesit subjekt të tatimit mbi fitimin	31 Mars	31 korrik 2020
Dorëzimi në e-tax i Deklaratës vjetore të Tatimit mbi Fitimin	Të gjithë tatimpaguesit subjekt të tatimit mbi fitimin	31 Mars	31 mars 2020 (nuk ka shtyrje të afatit)
Pagesa e Tatimit mbi Fitimin e detyrueshem për t'u paguar sipas Deklarates vjetore të Tatimit mbi Fitimin, pas zbritjes së parapagimeve dhe kreditimit të tatimit të huaj	Tatimpaguesit subjekt të tatimit mbi fitimin me qarkullim vjetor > 14 milione Lekë	31 Mars	31 mars 2020 (nuk ka shtyrje të afatit)
	Tatimpaguesit subjekt të tatimit mbi fitimin me qarkullim vjetor < 14 milionë Lekë	31 Mars	Kurdo nga 1 korriku deri më 31 dhjetor 2020
Parapagimi i kësteve tremujore të tatimit mbi fitimin për vitin 2020	Tatimpaguesit subjekt të tatimit mbi fitimin me qarkullim vjetor > 14 milionë Lekë	30 Mars 30 Qershor 30 Shtator 30 Dhjetor	30 mars, 30 qershor, 30 shtator, 30 dhjetor 2020 (nuk ka shtyrje te afateve)
	Tatimpaguesit subjekt të tatimit mbi fitimin me qarkullim vjetor < 14 milionë Lekë		Kurdo brenda 31 dhjetorit 2020

Parashikimet e mësipërme hyjnë në fuqi në mënyrë të menjëhershme duke filluar nga data 26.03.2020.



Re-schedule of the deadline for submission of financial statements and settlement of corporate income tax liabilities

In order to cope with the financial consequences caused by COVID-19, the Council of Ministers has approved the Normative Act no. 10, dated 26.03.2020 published in the Official Gazette no. 52, dated 26.03.2020, which provides for the extension of the deadline for submission of financial statements, as well as the declaration and payment of corporate income tax for the year ended on 31 December 2019, for certain categories of taxpayers.

It is important to emphasize that **these deadlines are only applicable to those taxpayers who are subject to the Law no. 8438, dated 28.12.1998 "On Income Tax" and not for taxpayers subject to the simplified corporate income tax on small businesses, which is regulated by Law no. 9632, dated 30.10.2006 "On the local taxes system"**. Hereinbelow are schematically presented, the new deadlines for submission and payment, as well as the categories of taxpayers to which such extended deadlines are applicable:

Legal obligation	Taxpayers' category	Regular legal deadline	Exceptional legal deadline for year 2020
Submission of the annual financial statements and the legal audit report (where obligatory) in the e-tax system	All taxpayers subject to corporate income tax	31 March	31 July 2020
Submission of the annual Corporate Income Tax return in the e-tax system	All taxpayers subject to corporate income tax	31 March	31 March 2020 (no deadline extension)
Settlement of payable Corporate Income Tax based on the annual CIT return, after deduction of CIT pre-payments and credit of foreign tax	Taxpayers subject to corporate income tax with an annual turnover > ALL 14 million	31 March	31 March 2020 (no deadline extension)
	Taxpayers subject to corporate income tax with an annual turnover < ALL 14 million	31 March	Anytime between 1 st of July up to 31 st of December 2020
Prepayment of quarterly corporate income tax installments for year 2020	Taxpayers subject to corporate income tax with an annual turnover > ALL 14 million	30 March 30 June 30 September 30 December	30 March, 30 June, 30 September, 30 December 2020 (no deadline extension)
	Taxpayers subject to corporate income tax with an annual turnover < ALL 14 million		Anytime within 31 December 2020

The above legal provisions are effective immediately starting on 26.03.2020.